



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 nëntor 2017
Nr. ref.: RK1152/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KIo5/17

Parashtrues

Osman Sylanaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 11 të Ligjit nr. 05/L-068 për
ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik
të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me
Ligjin nr. 04/L-237**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Osman Sylanaj nga Skenderaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i punësuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike (në tekstin e mëtejme: IKAP).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e nenit 11 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, lidhur me pjesën që ka të bëjë me kompetencat e Këshillit RRegullativ për Prokurimin Publik(KRPP)

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjit të kontestuar, për të cilin parashtruesi pretendon se është në kolizion me nenet 2 dhe 5 të Ligjit për IKAP-in (Ligji nr. 04/L-221 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 20 mars 2014) dhe i cili është në kundërshtim me nenin 112.1 [Parimet e Përgjithshme], nenin 79 [Nisma Legjislative] dhe nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 janar 2017, parashtruesi e dorëzoi nëpërmjet postës kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 27 shkurt 2017, Kryetarja e Gjykatës, me vendim, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 3 mars 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 3 korrik 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe unanimisht, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 31 gusht 2011, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (04/L-042), i cili u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 19 shtator 2011 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të tij.
10. Ligji në dispozitat relevante lidhur me rastin ka këtë përmbajtje:

Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit

“1. IKAP në bashkëpunim me është përgjegjës për zhvillimin e moduleve të trajnimit dhe kurrikulës për kualifikimet në prokurim. IKAP dhe KRPP duhet të identifikon personat, me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset e prokurimit të hartuara nga KRPP. IKAP duhet të aranzhojë zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. KRPP në bashkëpunim me IKAP siguron që kurse të tilla të përgatiten dhe mbahen nga një person i trajnuar ose organizatë e trajnimeve që ka ekspertizë substanciale në praktikat më të mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së.

2. IKAP do të jetë përgjegjës për organizimin e provimeve.

3. Çdo person i interesuar mund të marrë pjesë në trajnimin profesional të prokurimit. Autoriteti Kontraktues duhet që në lidhje me Zyrtarët e Prokurimit të punësuar të trajtojë kohën e shpenzuar nga Zyrtari i Prokurimit në trajnim si orar të zakonshëm pune dhe ta kompensojë atë njëjloj sikurse të kishte shpenzuar atë kohë në punë. Autoriteti kontraktues po ashtu mund t'i ofrojë personit në fjalë, në pajtim me aktet e zbatueshme ligjore dhe nënligjore edhe kompensim për shpenzimet që domosdoshmërisht janë bërë nga personi për pjesëmarrjen në trajnim.

4. IKAP do të lëshojë “certifikatën themelore profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset themelore dhe të cilët rekomandohen nga trajnuesi. IKAP do të lëshojë “certifikatën e avancuar profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset e avancuara”.

[...]

11. Më 14 janar 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237. Ligji u publikua në Gazetën Zyrtare të Kosovës, më 6 janar 2015 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas shpalljes së tij.
12. Ligji në nenin 11, i cili kontestohet nga parashtuesi i kërkesës dhe i cili ka ndryshuar përmbajtjen e nenit 25 të ligjit paraprak, ka këtë përmbajtje:

Neni 11

1. Neni 25 i ligjit bazik, paragrafët 1, 2, 4, 5, 6,7, 8, 9, riformulohen me tekstin si në vijim:

1. KRPP-ja është përgjegjëse për zhvillimin e moduleve të trajnimit dhe kurrikulës për kualifikimet në prokurim. KRPP-ja duhet të identifikojë personat, me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset e prokurimit të hartuara nga KRPP-ja. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in duhet të aranzhojë zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën 15

(pesëmbëdhjetë) ditë për trajnime bazike dhe 10 (dhjetë) ditë për trajnime të avancuara. KRPP-ja siguron që kurse të tilla të përgatiten dhe mbahen nga një person i trajnuar ose Institucion i trajnimeve që ka ekspertizë substanciale në praktikën më të mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së.

2. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in do të jenë përgjegjëse për organizimin e provimeve.

4. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in do të lëshojnë “certifikatën themelore profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset themelore dhe të cilët rekomandohen nga trajnuesi. KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in do të lëshojnë “certifikatën e avancuar profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset e avancuara.

[...]

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se dispozita e kontestuar e ligjit në fjalë i merr kompetencat e përcaktuara paraprakisht me ligjin bazik për prokurimin publik (neni 25, Ligji nr. 04L-042) dhe me Ligjin për IKAP-in ku trajnimet profesionale në fushën e prokurimit ishin kompetencë e IKAP-it e tani janë në kompetencë të KRPP-së.
14. Ky ndryshim i ligjit, sipas parashtruesit të kërkesës, bie në kolizion direkt me Ligjin për IKAP-in (nenet 2 dhe 5) dhe Ligjin për Shërbimin Civil, ndërsa drejtpërsëdrejti është në kundërshtim me nenet 16, 79 dhe 112 të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:
“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
17. Më tej, Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:
“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”
18. Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:
*“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar, ose
[...].”*

19. Në vlerësimin e kërkesës dhe kriterëve të pranueshmërisë dhe veçanërisht kushtit të palës së autorizuar për parashtrim të një kërkesë për shqyrtim, Gjykata konstaton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] shprehimisht përcakton:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

20. Bazuar në si më sipër është e qartë se Kushtetuta e Kosovës nuk ka paraparë mundësinë që një individ të kontestojë pajtueshmërinë e një ligji të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, por këtë kompetencë e ka paraparë për palët e autorizuar Presidentin e Republikës së Kosovës, Qeverinë dhe Avokatin e Popullit sipas nenit 113 .2, dhe për gjykatat e rregullta me nenin 113.8.
21. Përveç kësaj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, që është modalitet i ankesave individuale, dhe i mundëson çdo individ, që tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pyetje dhe me kërkesa të caktuara, duke aluduar për shkelje të të drejtave kushtetuese (shih Aktvendimin për papranueshmëri, rasti KI157/11 të parashtruesit Azem Ejupi "Kërkesë për rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve të Republikës së Kosovës nga autoritetet shtetërore" të 25 shkurtit 2013).
22. Në kushtet kur kërkesa është parashtruar nga një palë e paautorizuar Gjykata nuk mund të vlerësojë meritat e rastit dhe rrjedhimisht, as në rastin konkret, Gjykata nuk vlerëson pretendimet e parashtruesit të kërkesës nëse dispozitat e konstatuara janë apo jo në përputhje me Kushtetutën apo pretendimin tjetër lidhur me kolizionin eventual të ligjeve.
23. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk e ka përmbushur kushtin e palës së autorizuar sipas nenit 113.1 të Kushtetutës dhe rregullit 36 (1) (a) të Rregullores së punës, andaj kërkesa duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (a) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi